



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2614 prot.

Himarë, më 30.05.2022

V E N D I M

Nr. 26 datë 27.05.2022

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR RIORGANIZIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE
“UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, nenit 14, nenit 23 , nenit 54 shkronja “d” dhe shkronja “gj”, nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 12 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, VKM-së nr. 431, datë 11.7.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, dhe VKM-së nr.302 , datë 11.05.2022 “ Këshilli Bashkiak Himarë ne mbledhjen e tij te dt: 27.05.2022 pasi shqyrtoi matërialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike miratoi me shumicë vote dhe ...

V E N D O S I :

1. Të japë miratimin për riorganizimin e shoqërisë aksionare “Ujësjellës Kanalizime Himarë”, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.
2. Të japë miratimin për lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin, trajtimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit, sipas lidhjes nr.4 “ Harta territoriale e shoqërive SKP që krijohen” të VKM-së nr.302 , datë 11.05.2022 “ Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, si më poshtë:

Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a

Vlorë
Selenicë
Himarë

3. Të japë miratimin që Kryetari i Bashkisë Himarë Z.Jorgo Goro, të përfaqësojë Bashkinë Himarë, në nënshkrimin e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta dhe në të gjitha procedurat administrative- ligjore në zbatim të kësaj marrëveshje.
4. Ngarkohet e gjithë struktura organizative në Bashkinë e Himarës dhe Shoqëria Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Himarë” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

Kryetari

Dhimitër Kapaj

